



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.257/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Herolind Sejday nga fshati Dubravë, Komuna e Istogut, për shkak të pa rregullsive gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.257/2017 i datës 12.06.2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë .

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 12 qershor 2017 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, me të cilën pretendohet se me datën 11.06.2017, në Qendrën e Votimit QV nr.1609c/02d, në fshatin Dubravë, KK Istogut është vërejtur se Herolind Sejday ka bërë bartjen e votuesve për të votuar. Më këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se Herolind Sejday ka kryer vepër penale “Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve”, e cila parashihet sipas nenit 213 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës KPRK.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 i LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtuesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se Herolind Sejday në Qendrën e Votimit QV nr.1609c/02d, në fshatin Dubravë, KK Istogut, i ka përcjell votuesit për të votuar.

PZAP-i konstaton se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi në cilësi të provës edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtuesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 paragrafi 3 i LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar e ka bërë bartjen e votuesve në Qendrën e Votimit nr. QV 160 9c/02d gjatë ditës së votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.257/2017 i datës 13.06.2017

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit njëzet e katër (24) orë nga momenti i marrjes-[r]animimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.



Kryesues i Panelit

Fejzullah Rexhepi